

EKSTRAKT

MBI AUDITIMIN E KREYR NË INSTITUTIN E NDËRTIMIT TIRANË

Në zbatim të programit të auditimit, nr. 758/2, datë 21.02.2014, të miratuar nga Ministri, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e MZHUT ka zhvilluar misionin e auditimit të plotë (mbi bazë sistemi), mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në Institutin e Ndërtimit (IN) Tiranë, për periudhën 01.01.2013 - 31.12.2013.

Gjatë realizimit të këtij angazhimi janë konstatuar shkelje të ligjshmërisë sa vijon:

✚ Mosndjekje e moszbatim i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. Kështu, nga 10 rekomandime të lëna nga 2 auditimet e fundit janë realizuar vetëm 3, realizuar pjesërisht 4 dhe nuk janë realizuar 3 rekomandime.

✚ Kryerja e pagesave për kualifikime (master) për drejtuesin e Institutit, në kundërshtim me përcaktimet e lidhjes nr. 2/1, të VKM nr. 449, datë 11.07.2012, "Për një ndryshim në VKM nr. 545, datë 11.08.2011, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e Ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të pavarura, Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, Institucione në varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit", dhe Udhëzimit të përbashkët të MF, MASH dhe DAP, duke shkaktuar shkelje të disiplinës financiare, në masën 405.000 lekë.

✚ Veprime në kundërshtim me kreun VI, pika 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 28.03.2013, "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla" i ndryshuar, pasi për blerje dhe shërbime në shumën 53.250 lekë, nuk janë kryer procedurat e parashikuara në legjislacionin e mësipërm, shoqëruar me shkelje të disiplinës financiare.

✚ Mosrespektim të kërkesave të nenit 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues" të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, ku cilësohet se: *"Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike".*

✚ Evidentohen rritje të të drejtave të pa arkëtuara (klientë) me 11.8 milionë lekë brenda dy viteve, pasi teprica e kësaj llogarie nga 7.794.631 lekë në fund të vitit 2011, paraqitet në shumën 19.660.464 lekë më datë 31.12.2013. Njëkohësisht, janë rritur borxhet për t'u paguar ndaj të tretëve (detyrimet kreditore) me afro 4 herë, brenda vitit, pasi nga 3.963.952 lekë që rezultonin në fillim të vitit 2013, paraqiten në shumën 15.535.358 lekë me datën 31.12.2013.

✚ Janë kaluar në ngarkim të shpenzimeve të Institutit disa pagesa të gjobave dhe interesat e tyre, në vlerën 109.396 lekë, aplikuar kryesisht nga mosdeklarimi në afat i rezultatit financiar të vitit 2012 pranë organit tatimor dhe nga moslikujdimi në kohë i taksave dhe tarifave vendore.

✚ Mangësi në administrimin e shpenzimeve të karburantit dhe mosdokumentimi i lëvizjeve të automjeteve, në dispozicion të titullarit të institucionit, veprime këto, në kundërshtim me kërkesat e administrimit dhe dokumentimit të vlerave materiale të përcaktuara në UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

✚ Janë konstatuar shkelje të normave dhe standardeve të kontabilitetit, miratuar me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël". Kështu,

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike, në librat e kontabilitetit, nuk referohet mbi të dhënat e nevojshme dhe ekstremitetet e dokumentacionit justifikues.

- Janë kryer pagesa të kreditorëve, për shërbimin e oponencave, pa i evidentuar në kontabilitet, si detyrime të mbartura (*likujduar 10 raste për llogari te viteve 2011-2012, në shumën 1.763.671 lekë*).

- Dokumentacioni bazë mbështetës ishte i pa sistemuar.

- Regjistrimi i veprimeve me 4 bankat që operonte IN, nuk sintetizohej në një ditar përmbledhës.

- Pagesat e kryera nëpërmjet bankës nuk kishin bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, urdhërues, justifikues, etj

- Borderotë nuk ishin të hartuara me të gjithë elementët referues, siç përcakton shtojca 4 e Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.1/1, datë 19.02.2013, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

- Regjistrimi i lëvizjes së vlerave monetare nga arka në bankë dhe midis bankave, ka rezultuar me pasaktësi dhe rrjedhimisht, mungesë rakordimi të llogarisë 581 "Xhirimi i vlerave monetare", që për vitin 2013 nuk rezulton e mbyllur.

✚ Nga IN janë realizuar, në total, 86 oponenca me një vlerë të ardhurash, të llogaritur, prej 21.498.902 lekë dhe për këtë janë paguar bashkëpunëtorë të jashtëm në shumën 4.079.346 lekë ose 19% e shumës së mësipërme. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve në oponenca teknike nga ana e Institutit, është kryer pa asnjë procedurë prokurimi. Kontraktimi i oponentëve në këto shërbime konsulence nuk i është nënshtruar konkurimit.

- Mungon gjurma e përzgjedhjes së ofertës më të ulët financiare.

- Hartimi dhe miratimi i listës të bashkëpunëtorëve në oponenca nuk mbështetet mbi kriteret të shpalluar paraprakisht.

-Lista vjetore e bashkëpunëtorëve është miratuar nga KD, por përcaktimi i subjekteve, për çdo oponent të projekteve teknike është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka lidhur edhe aktmarrëveshjet.

-Janë aplikuar nivele të ndryshme të shpërblimit të oponentëve, që variojnë nga 14% deri në 40% të vlerës së oponentit të kontraktuar.

✚ Në rënien e të ardhurave të IN ka ndikuar mungesa e akreditimit të laboratorit të tij. Konstatohet se, për periudhën 2007- 2012, ky laborator ishte i pajisur nga METE me certifikatën e akreditimit. Ky status nuk gëzohet për vitin 2013 dhe në vazhdim, pavarësisht se janë shlyer detyrimet financiare për përfitimin e akreditimit.

✚ IN nuk ka hartuar gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore, dhe nuk kishte ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), për periudhën e auditimit. Veprime këto në shkelje të kërkesave të nenit 16, pika 2 dhe 3, neneve 8, 10 dhe 27, të ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të detyrimeve të kapitullit III, të “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, datë 15.07.2010. Kjo kërkesë është dhe detyrim i kreut I, pika 1 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin e mëparshëm buxhetor”.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, të trajtuara gjatë procesit të auditimit, të evidentuara në projekt raportin dhe në raportin final të angazhimit të auditimit, për përmirësimin e punës, në të ardhmen, mbështetur në kërkesat e Ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, në Manualin e Auditimit të Brendshëm (miratuar nga MF me nr. 69, datë 29.9.2010), Udhëzimit të MF nr. 12, datë 29.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, për përmirësimin e punës janë rekomanduar për zbatim:

1. 15 masa organizative dhe të forcimit të kontrolleve të brendshme,
2. 3 masa të shpërblimit të dëmeve , nga 4 persona për vlerën 576,646 lekë.
3. 6 masa disiplinore ndaj zyrtarëve, nga këto 1 largim nga puna, 1 kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët, 3 vërejtje me shkrim dhe 1 pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë.